



Nr./Br. 1029-09

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63.4 dhe 74 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.10.2009 nxjerr këtë:

VENDIM

Për pajisjen e anëtarëve të KVV-ve me ID me foto për Zgjedhjet Komunale të 15 nëntorit 2009

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes këtij vendimi miraton propozimin për pajisjen e ID-ve të anëtarëve të KVV-ve me foto për Zgjedhjet Komunale të 15 nëntorit 2009 si dhe Raundin e II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave.
- II. Fotoja me madhësi të fotos së letërnjoftimit do të vendoset në kuadër të ID-së së anëtarit të KVV-së në atë mënyrë që të mos mbulojë ndonjë pjesë të informatave/të dhënave të anëtarit të KVV-së në ID. Fotoja e ngjitur mbi ID të anëtarit të KVV-së do të vuloset me vulën e Komunës përkatëse.
- III. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së që përmes Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) të ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e këtij vendimi.

Prishtinë, 21.10.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve